



KOMITETI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Raport Vjetor 2021

25 Nëntor 2022

Përgatitur nga:
Altin Sulejmani
Fatmira Kastrati
Eljona Hoxha

Përgatitur për:
Asamblenë e Përgjithëshme të IEKA-s

Përmbajtja e Lëndës

Lista e shkurtimeve.....	3
I. Përmbledhje ekzekutive.....	4
II. Baza ligjore	4
III. Organizimi dhe qeverisja.....	4
IV. Komitet dhe aktiviteti i tyre.....	7
V. Veprimtaria financiare.....	9
VI. Analiza për llogaritë e pasqyrës së pozicionit financiar	10
VII. Pajtueshmëria e llogarive me buxhetin.....	13
VIII. Konstatime dhe rekomandime	15
IX. Aneksi I	17

Lista e shkurtimeve

AL	Auditues Ligjor
APA	Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve
BMP	Bordi i Mbikqyrjes Publike
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
KD	Këshilli Drejtues
KEKV	Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit të Vjueshëm Profesional
KEPP	Komiteti i Edukimit dhe Praktikës Profesionale
KIB	Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës
KKB	Komiteti i Kontrollit të Brendshëm
KKC	Komiteti i Kontrollit të Cilësisë
KKV	Komiteti i Kualifikimit të Vjueshëm
KPAMA	Komiteti i Programeve Alternative dhe Metodologjisë së Auditimit
KR	Komiteti i Regjistrimit
KSP	Komiteti i Standardeve Profesionale
KSPE	Komiteti i Standardeve Profesionale dhe të Etikës

I. Përmbledhje ekzekutive

Në përputhje me statutin e Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjorë, Komiteti i Kontrollit të Brendshëm i paraqet Asamblesë së Përgjithshme të IEKA-s raportin vjetor me fokus kryesor veprimtarinë financiare të Institutit dhe pajtueshmërinë e veprimeve të regjistruara me buxhetin e aprovuar nga Asambleja. Në këtë kuadër, raporti vjetor mbi veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm të IEKA-s, fokusohet në drejtimet e mëposhtme:

1. Komunikon rezultatet e veprimtarisë së auditit të brendshëm. Raporti përçon problemet më të rëndësishme të identifikuar dhe të trajtuara, tregon ecurinë drejt përmirësimeve të vazhdueshme dhe veprimeve korrigjuese, si dhe sfidat e përpyekjet e për të siguruar pajtueshmërinë me kuadrin legjislativ.
2. Raporti trajton menaxhimin e burimeve, treguesit dhe matësit e performancës, si dhe shkallën e pajtueshmërisë me buxhetin e aprovuar.
3. Raporti përmbillet me planin e punës së Komitetit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2023, i cili synon një kontroll të plotë të regjistrimeve kontabël nga fillimi i mbajtjes së të dhënave në programin financiar të përdorshëm nga IEKA (Alpha), me përqendrim në çështjet me risk të lartë sipas vlerësimit të kryer nga analiza e përgjithshme e regjistrimeve dhe pasqyrave financiare. Synimi përfundimtar është rritja e cilësisë së kontrollit të brendshëm.

II. Baza ligjore

Kuadri ligjor dhe procedural i auditimit të brendshëm përfaqësohet nga:

- Ligji 10 091, datë 05/03/2009, i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”;
- Ligji nr.8788, datë 07/05/2001, “Për organizatat jofitimprurëse”;
- Statuti i organizatës profesionale të audituesve ligjorë, “Institutit i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar”;
- Vendimet e Këshillit Drejtues të IEKA-s;
- Rregullore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
- VKM nr. 786, datë 09.11.2016, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të BMP”;
- Rregulloret e BMP-së;
- Vendimet e nxjerra nga BMP-ja;

III. Organizimi dhe Qeverisja

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) është një organizatë jofitimprurëse e krijuar në 24 nëntor të vitit 1997, bazuar në nenin 16 të Urdhërësës nr. 1 datë 02/10/1995 të Këshillit të Ministrave me statusin e një shoqate profesionale jofitimprurëse, që grupon profesionistët kontabël të pajisur me titullin “Auditues Ligjorë” të cilët e ushtrojnë profesionin e tyre në praktikën publike në

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2021

mënyrë të pavarur ,në statusin e personave fizikë ose në përbërje të shoqërive audituese. Në vijim, me vendimin e gjykatës nr.3573, datë 16/10/1998, IEKA, u regjistrua si person juridik, pranë Gjykatës së Rrethit të Tiranës.

Objekti kryesor i veprimtarisë së IEKA-s është të sigurojë ushtrimin e profesionit të audituesve ligjorë në përpunje të plotë me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe të nderit të anëtarëve të saj.

Organi më i lartë i vendimmarrjes së IEKA-s është Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, e përbërë nga 240 anëtarë aktivë deri në 31 dhjetor 2021.

Organi drejtues i IEKA-s është Këshilli i Drejtimit i përbërë nga 6 anëtarë dhe kryetari i saj. Këshilli Drejtues ka pasur ndryshime të vazhdueshme gjatë viteve 2019-2022. Më konkretisht, gjatë vitit 2021 përbërja e Këshillit Drejtues ka qënë si më poshtë

		<u>Pozicioni</u>	<u>Afati i Mandatit</u>
Z. Berti PASHKO	-	Kryetar	Shtator 2023
Z. Arqile MISHTAKU	-	Zv/Kryetar	Shtator 2021
Z. Bujar OSMANI	-	Anëtar	Shtator 2021
Z. Shkëlzen MARGJEKA	-	Anëtar	Shtator 2021
Z. Arian CYRBJA	-	Anëtar	Shtator 2023
Zj. Rezarta KOÇOLLARI	-	Anëtar	Shtator 2023
Z. Elton TIRANA	-	Anëtar	Shtator 2023

Këshilli Drejtues në fuqi më 31 dhjetor 2021, është zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve në mbledhjen e dt.15 tetor 2021 me vendimet nr. 147, 148, 149, 150 me një mandat 4 vjeçar. Përbërja e tij, më 31 dhjetor 2021, është si më poshtë:

	<u>Pozicioni</u>	<u>Afati i Mandatit</u>
Z. Berti PASHKO	Kryetar	Tetor 2025
Zj.Shpresa BERÇANI	Zv/Kryetar	Tetor 2025
Z. Edrian MESLANI	Anëtar	Tetor 2025
Z. Erjon SARAÇI	Anëtar	Tetor 2025
Zj. Esmeralda BALLUKU	Anëtar	Tetor 2025
Zj. Nuriona BËRDICA	Anëtar	Tetor 2025
Zj.Orjana Kalaja	Anëtar	Tetor 2025

Këshilli Drejtues ka pësuar ndryshime gjate vitit 2022 si rrjedhojë e dorëheqjes së disa prej anëtarëve të saj, përkatësisht në muajt shkurt, prill dhe maj. Me dorëheqjen e anëtarit të tretë në maj të vitit 2022, bazuar në nenin 17 të statutit të IEKA-s, është mbledhur Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve, ku një ndër pikat e rendit të ditës ishte dhe zgjedhja dhe zëvendësimi i tre anëtarëve të dorëhequr gjatë periudhës shkurt - maj 2022.

Organi Ekzekutiv i IEKA-s është Drejtori Ekzekutiv i saj, i zgjedhur nga Këshilli Drejtues me vendimin nr. 47 më datë 9 nëntor 2021 në mbështetje të kërkesave të nenit 28.3 të statutit të saj. Drejtori

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2021

ekzekutiv i zgjedhur për sa më lart, ka qenë i komanduar në pozicionin e drejtorit ekzekutiv nga data 9 tetor 2021, me vendimin 44 të KD-së të asaj periudhe.

IEKA ka gjithashtu, administratën ekzekutive me përbërjen e mëposhtme në dt.31 dhjetor 2021:

- | | | | |
|----|------------------|---|--|
| 1. | Arminda Qylafku | - | Drejtor Ekzekutiv |
| 2. | Silvi Buzi | - | Specialist Edukimi |
| 3. | Klementina Kuqja | - | Specialist Edukimi dhe Financë Kontabiliteti |
| 4. | Kejsi Çela | - | Sekretaria, Protokoll |
| 5. | Sara Shurdhi | - | Specialist, Standardet profesionale |
| 7. | Albana Pllaha | - | Mirëmbajtje (pastrim) të ambienteve |

Organi i kontrollit të veprimtarisë financiare dhe përputhshmërisë së aktiviteteve të IEKA-s është Komiteti i Kontrollit të Brendshëm. Organizimi dhe funksionimi i KKB-së rregullohet nga nenet 8 dhe 9 të ligjit 10091 datë 05.03.2009, i ndryshuar, si dhe nga nenet 24 dhe 25 të statutit të IEKA-s.

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm ka pësuar ndryshime sikurse të gjitha organet e tjera të IEKA-s gjatë vitit 2021. KKB-ja, e përbërë nga Elida Miti dhe Sokol Toska është shkarkuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve me vendimin nr.149, me datë 15/10/2021. Në 31 dhjetor 2021 nuk ka pasur një Komitet të Kontrollit të Brendshëm efektiv. Në këtë kuadër, IEKA ka shpallur vendet vakante të KKB-së dhe thirrjen për shprehje interesi nga ana e anëtarëve të saj. Në mbledhjen e radhës së APA-së, më datë 11 janar 2022 është bërë votimi i fshehtë për zgjedhjen e 3 anëtarëve të KKB-së. Sipas vendimit 153, datë 11/01/2022 është krijuar Komiteti i Kontrollit të Brendshëm me përbërjen si më poshtë:

- | | | |
|------------------|---|---------|
| Altin Sulejmani | - | Kryetar |
| Fatmira Kastrati | - | Anëtar |
| Meri Lika | - | Anëtar |

Pas dorëheqjes së Znj Meri Lika nga anëtare e KKB-së dhe, në vijim të vendimit të marrë nga KKB më datë 21/07/2022, në zbatim të nenit 24/8 të statutit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë, IEKA, u bë zëvendësimi i anëtarit të dorëhequr me anëtarin tjetër, i cili ka paraqitur kandidaturën dhe ka fituar numrin më të madh të votave pas kandidatëve të zgjedhur si anëtarë, zj. Eljona Hoxha.

Organi mbikqyrës i anëtarësisë së IEKA-s është Bordi i Mbikëqyrjes Publike, i përbërë nga kryetari, anëtarët e bordit, drejtori ekzekutiv dhe struktura mbështetëse. Anëtarët e Bordit emërohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, me një mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë. Përbërja aktuale e BMP-së, miratuar me urdhërin e Minsitrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 29/1 me datë 01/12/2021 “Për emërimin dhe mandatin e kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Publike” është si më poshtë:

- | | | |
|-----------------|---|-------------------|
| Dritan Fino | - | Kryetar |
| Adriana Berberi | - | Anëtar |
| Luan Abazi | - | Anëtar |
| Martin Mici | - | Anëtar |
| Gjergji Duro | - | Anëtar |
| Aldo Spahiu | - | Drejtor Ekzekutiv |

Misioni i BMP-së është të rrisë sigurinë në auditimet ligjore të cilat kryhen në një mjedis transparent, të

kontrolluar dhe të kujdesshëm e në shërbim të interesit publik si dhe përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar.

IV. Komitetet dhe aktiviteti i tyre

IEKA ushtron të drejtat dhe detyrimet ligjore dhe statutore dhe krijon komitete të cilat emërohen nga Këshilli Drejtues dhe organizohen mbi bazën e parashikimeve ligjore dhe statutore. Gjatë vitit 2021 komitet të cilat kanë funksionuar deri në muajin tetor dhe aktiviteti i tyre mund të përmbledhet si më poshtë:

1- Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshëm Profesional i cili angazhohet në hartimin e politikave për edukimin e kandidatëve dhe të kualifikimit të vijueshëm profesional. KEKV i propozon Këshillit Drejtues programet e edukimit dhe të kualifikimit të vijueshëm profesional si dhe mënyrën e monitorimit dhe vlerësimit të procesit të zhvillimit të vijueshëm të anëtarëve.

Përbërja e Komitetit të Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshëm Profesional (KEKV), sipas vendimit Nr.36, datë 17.10.2019 të Këshillit Drejtues është si më poshtë:

Rezarta Koçollari	-	Kryetar
Kledian Kodra	-	Anëtar
Doranin Agalliu	-	Anëtar
Julian Naqellari	-	Anëtar

KEKV e zgjedhur me vendim Nr.36, datë 17.10.2019 të Këshillit Drejtues deri në muajin tetor të vitit 2021 ka zhvilluar tri (3) mbledhje.

Me vendimin nr. 51, datë 16.11.2021 të Këshillit Drejtues, zj. Rezarta Koçollari është zëvendësuar me zj. Nuriona Bërdica dhe, mbas kësaj datë, ka zhvilluar tri (3) mbledhje.

Sa më sipër rezulton se gjatë vitit 2021 KEKV-ja ka zhvilluar në total gjashtë (6) mbledhje.

2-Komiteti i Regjistrimit i cili merret me zbatimin e procedurave të regjistrimit dhe të ç' regjistrimit nga regjistri publik i audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit vendase dhe të huaja, ka zhvilluar gjatë vitit 2021, pesë mbledhje.

Përbërja e Komitetit të Regjistrimit deri në dhjetor 2021 ka qenë si më poshtë:

Bujar Omani	-	Kryetar
Saimir Muçmataj	-	Zv/Kryetar
Leze Abazi	-	Anëtar
Arian Çyrbja	-	Anëtar
Ilir Meçe	-	Anëtar

Komiteti i Regjistrimit ka pësuar ndryshime gjatë dy viteve të fundit:

1. Z. Saimir Muçmataj dhe z. Ilir Meçe kanë zëvendësuar znj. Kesjana Halili dhe znj. Elisa Çela si përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me vendimin nr.30, datë 13.04.2021, të Këshillit Drejtues.

2. Z. Arian Çyrbja është emëruar anëtar i Komitetit të Regjistrimit me vendimit nr.16, datë 09.02.2021 të Këshillit Drejtues, i cili ka zëvendësuar zj. Elvira Hoxha pasi ka dhënë dorëheqjen.

3- Komiteti i Standardeve Profesionale merret me trajtimin e çështjeve dhe kërkesave për interpretim lidhur me zbatueshmërinë e standardeve profesionale dhe të kodit të etikës. Ky Komitet do të ofrojë mbikëqyrjen e adoptimit, implementimit dhe zbatimit të standardeve profesionale dhe Kodit të Etikës. Gjatë vitit 2021 ky komitet ka zhvilluar vetëm një mbledhje.

Përberja e Komitetit të Standardeve Profesionale sipas vendimit nr.36, datë 17.10.2019 të Këshillit Drejtues, është si më poshtë:

Berti Pashko	-	Kryetar
Artan Xhiani	-	Anëtar
Hysen Çela	-	Anëtar

4-Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës ka për qëllim zbulimin, korigjimin dhe parandalimin e mangësive që mund të vërehen gjatë kryerjes së shërbimit të auditimit ligjor dhe të shërbimeve profesionale të tjera të lidhura nga audituesit ligjorë si dhe zbatimin e një regjimi investigimi që ka në themel respektimin e të drejtave të palëve.

Përberja e Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës në mbështetje të vendimit nr.36, datë 17.10.2019, të Këshillit Drejtues ka qënë si më poshtë:

Shkëlzen Margjeka	-	Kryetar
Elton Tirana	-	Anëtar
Arian Dhimërtika	-	Anëtar

Zj. Majlinda Maqellari ka humbur jetën dhe në këtë kushte, me vendimin nr.16, datë 09.02.2021 të Këshillit Drejtues, është zëvendësuar me z. Arian Dhimërtika.

Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës gjatë viti 2021 nuk ka zhvilluar asnjë mbledhje.

5-Komiteti i Kontrollit të Cilësisë ka objektiv të verifikojë dhe të japë siguri të arsyeshme që audituesit ligjorë dhe/ose ortakët e angazhimit dhe shoqëritë e auditimit respektojnë kërkesat ligjore dhe rregulla të tjera të brendshme të Institutit dhe se organizimi i firmave të auditimit u përgjigjet nevojave të ushtrimit të profesionit.

Përberja e Komitetit të Kontrollit të Cilësisë sipas vendimit nr.36, datë 17.10.2019 të Këshillit Drejtues, ishte si më poshtë:

Arqile Mishtaku	-	Kryetar
Vera Lala	-	Anëtar
Erjon Pjetërnika	-	Anëtar
Brunilda Stefa	-	Anëtar

Me vendimin nr.16, datë 09.02.2021 të Këshillit Drejtues në Komitetin e Kontrollit të Cilësisë është shtuar si anëtare zj.Elvara Hoxha. Komiteti i Kontrollit të Cilësisë është mbledhur dy (2) herë gjatë vitit 2021.

6-Këshilli i Botimit të Revistës Kontabilitet & Auditim ka si funksion drejtimin dhe monitorimin e procesit të publikimit të Revistës periodike Kontabilitet, Financë & Auditim duke filluar nga përzgjedhja e artikujve të cilat do të publikohen deri te publikimi përfundimtar i revistës.

Përberja e Këshillit të Revistës Kontabilitet & Auditim sipas vendimit nr.36, datë 17.10.2019 i Këshillit Drejtues është si më poshtë:

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2021

Berti Pashko	-	Kryetar
Orfea Dhuci	-	Anëtar
Elvira Hoxha	-	Anëtar
Fatian Devija	-	Anëtar
Tedi Ziko	-	Anëtar

Këshilli i Botimit të Revistës Kontabilitet & Auditim gjatë vitit 2021 nuk ka zhvilluar asnjë mbledhje.

Në fund të vitit 2021, Këshilli Drejtues, me vendimin nr. 60 datë 06/12/2021 ka ristrukturuar të gjitha komitetet duke lënë detyra për secilin komitet të hartojë rregulloret e funksionimit të tyre si dhe plotësimit me anëtarë. Sipas këtij vendimi, komitetet e reja dhe emërtimet përkatëse janë si më poshtë:

1. Komiteti i Edukimit dhe Praktikës Profesionale
2. Komiteti i Kualifikimit të Vijueshëm
3. Komiteti i Programeve Alternative dhe Metodologjisë së Auditimit
4. Komiteti i Kontrollit të Cilësisë për Auditimin Ligjor dhe për Shërbimet e Lidhura
5. Komiteti i Standardeve Profesionale dhe të Etikës
6. Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës
7. Komiteti i Regjistrimit

V.Veprimtaria Financiare

Veprimtaria e IEKA-s rregullohet sipas:

- Ligjit nr. 10091, datë 05/03/2009 “Për Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar me ligjin 47/2016;
- Statutit të IEKA
- Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Roli kryesor i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar është të rregullojë organizimin e profesionit të “Audituesit Ligjor” dhe të sigurojë që anëtarët e tij kryejnë me efektivitet auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara të shoqërive tregtare.

Çdo anëtar i IEKA- s në misionin e tij në shërbim të interesit publik, duhet të zbatojë standarde cilësore profesionale dhe etike dhe të marrë rolin e drejtuesit, duke ofruar një shërbim dinamik e praktik, i cili kontribuon në një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Në këtë kuadër, veprimtaria e IEKA-s konsiston në organizimin e profesionistëve në lidhje me ushtrimin e profesionit në përputhje me interesat e publikut, mbrojtjen e pavarësisë dhe nderit të anëtarëve të tij, kualifikimin e vijueshëm profesional dhe njohjen me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Nga ana tjetër, çdo anëtar i Institutit ka detyrimin të paguajë kuotat e anëtarësimit sipas përcaktimit të statutit të IEKA-s dhe vendimeve të Këshillit të Drejtimit, i cili mund të ndryshojë nivelin e këtyre kuotave.

Për vitin 2021 kuotat e aplikuara janë si më poshtë:

- Kuota fikse në shumën 60'000 lekë për çdo anëtar aktiv në profesion. Kjo kuotë është ulur nga 70'000 lekë në 60'000 me vendimin 146, më datë 17.12.2020 të marrë nga APA.
- Kuota fikse në shumën 8'000 lekë për çdo anëtar jo-aktiv në profesion.
- Kuota variabël 0,5% të qarkullimit total deri 8 milionë lekë dhe 0,3% të qarkullimit total mbi 8 milionë lekë.

Të ardhurat nga kuotat e ndryshme apo trajnimet e realizuara shërbejnë për të përballuar shpenzimet kryesisht të përbëra si më poshtë:

- Pagesat e honorarëve të Këshillit Drejtues dhe të komiteve;
- Kuotat për pjesëmarrje në organizatat ndërkombëtare;
- Pagat e personelit dhe shpenzime të tjera administrative;
- Kostot e shërbimeve nga të tretët në kryerjen e veprimtarisë së vet;
- Kostot për organizimin e trajnimeve të vijueshme dhe aktiviteteve të tjera në funksion të anëtarëve të saj

VI. Analiza për pozicionet e raportuara në pasqyrat financiare të IEKA-s për periudhën 01.01.2021-31.12.2021

Pasqyrat financiare të IEKA-s u kontrolluan nga KKB-ja sipas planit të punës të aprovuar prej saj, për kryerjen e këtij misioni. Konkretisht, kontrolli u krye si më poshtë paraqitur:

1. Kontrolli mbi llogaritë e të drejtave të arkëtueshme dhe të të regjistruara në kontabilitetin e Institutit.

Nga kontrolli i regjistrimeve kontabël, sipas zgjedhjes rastësore të kampionit të këtyre të drejtave, rezultuan këto probleme:

- Ka çelje të detyrimeve për AL-të për kuotën variabël, të mbartura nga vitet e kaluara, të cilat, duke u rakorduar me derdhjet e kryera prej tyre po gjatë vitit 2021, japin saldo debitore dhe kreditore. Këto të drejta të IEKA-s ndaj AL-ve janë paraqitur në llogaritë kontabël të numërtuara me llogarinë prind 411. Tepërcat e tyre, debitore apo kreditore, tregojnë ose pasaktësi në regjistrimet kontabël të tyre ose tregojnë se vinë si rrjedhojë e mosrakordimit të deklarimeve të detyrimeve të paraqitura në pasqyrat e misioneve vjetore të AL-ve me kontabilitetin e IEKA-s.

Totali i saldoeve të mbartura e të pashpjeguara për llogaritë 411, për 72 AL është 651,131 lekë
--

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2021

Nr. rend	Nr. llogarisë	Vlera e të drejtave të mbartura të pashpjeguar dt.01.01.2021	Vlera e diferencës së të drejtave të kontabilizuara me vlerën e paguar nga AL	Totali i vlerave të padrejta të paraqitura në kontabilitet si të drejta të IEKA-s ndaj AL-ve	Vlera e kontabilizuar për llogari të KV për vitin 2021	Parapagime për llogari të vitit 2021	Vlera totale e të drejtave të IEKA-s ndaj AL-ve të paraqitura në kontabilitet
1	41103	33 160		33 160	38 000		71 160
2	41104	17 568		17 568	-		17 568
3	41105	17 300		17 300	-		17 300
4	41107	(20 428)		(20 428)	60 127		39 699
5	41108	(1 677)		(1 677)	35 800		34 123
6	41109	(1 445)		(1 445)	-		(1 445)
7	411010	5 885		5 885	-		5 885
8	411011	13 055		13 055	-		13 055
9	411012	(1 573)		(1 573)	38 985		37 412
10	411015	450		450	18 335		18 785
11	411016	1 912		1 912	31 120		33 032
12	411017	-		-	54 286		54 286
13	411018	833		833	53 258		54 091
14	411019	16 010		16 010	2 040		18 050
15	411020	23 865		23 865	44 407		68 272
16	411022	228		228	106 906	(50 000)	57 134
17	411024	(11 384)		(11 384)	-	(18 605)	(29 989)
18	411026	(4 000)		(4 000)	106 633	(90 000)	12 633
19	411027	(5 041)		(5 041)	54 490		49 449
20	411028	48 995		48 995	55 003		103 998
21	411030	71 476		71 476	36 750		108 226
22	411031	(33 386)		(33 386)	259 320		225 934
23	411033	(12 053)		(12 053)	16 925	(16 000)	(11 128)
24	411035	34 013		34 013	56 131	(35 000)	55 144
25	411036	46 961		46 961	15 816		62 777
26	411039	(44 060)		(44 060)	39 380		(4 680)
27	411040	(12 895)		(12 895)	39 490		26 595
28	411041	53 300		53 300	-		53 300
29	411042	(8 078)		(8 078)	19 940		11 862
30	411043	980		980	24 060		25 040
31	411044	(81)		(81)	20 600		20 519
32	411045	38 137		38 137	53 647		91 784
33	411046	2 040		2 040	12 526		14 566
34	411047	500		500	59 992		60 492
35	411048	(2 154)		(2 154)	35 275		33 121
36	411049	1 878		1 878	82 276		84 154
37	411050	(804)		(804)	14 280		13 476
38	411053	(18 912)		(18 912)	89 890		70 978
39	411054	20 265		20 265	11 760		32 025
40	411055	11 095		11 095	-		11 095
41	411057	48 685		48 685	9 075		57 760
42	411058	12 453		12 453	-		12 453
43	411059	(5 100)		(5 100)	-		(5 100)
44	411060	(30 110)		(30 110)	29 625		(485)
45	411061	77 512		77 512	-		77 512
46	411062	33 450		33 450	-		33 450
47	411063	14 262		14 262	36 250		50 512
48	411064	(6 893)		(6 893)	23 605		16 712
49	411066	(42)		(42)	30 818		30 776
50	411067	(2)		(2)	-		(2)
51	411068	(4 012)		(4 012)	10 205		6 193
52	411069	(5 278)		(5 278)	-		(5 278)
53	411072	(32 800)		(32 800)	44 161		11 361
54	411073	337 481		337 481	-		337 481
55	411074	10 724		10 724	-		10 724
56	411075	66 017		66 017	-		66 017
57	411078	(35 235)		(35 235)	-		(35 235)
58	411079	32 549		32 549	-		32 549
59	411080	20 872		20 872	72 991		93 863
60	411081	(3 978)		(3 978)	54 919		50 941
61	411082	11 760		11 760	19 635		31 395
62	411083	(17 074)		(17 074)	50 988		33 914
63	411084	(63 529)		(63 529)	73 015		9 486
64	411085	(80 985)		(80 985)	128 194	(78 000)	(30 791)
65	411086	(35 626)		(35 626)	49 893	-	14 267
66	411087	(7 353)		(7 353)	109 051	(25 000)	76 698
67	411088	-		-	37 860		37 860
68	411089	25 418		25 418	39 966		65 384
69	411090	(500)		(500)	25 870		25 370
70	411091	(2 885)		(2 885)			(2 885)
71	411092	1 325		1 325	13 520		14 845
72	411093	8 090		8 090	-		8 090
				-			-
				-			-
	TOTALI	651 131	-	651 131	2 447 089	(312 605)	2 785 615

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2021

- E njëjta situatë e mosdhënies së shënimeve shpjeguese paraqitet edhe për saldot debitore të llogarive 467, me të cilat jepen detyrimet e AL-ve (aktivë e pasivë) për kuotat fikse:

1	46724	132 950		132 950	-		132 950			
2	46725			-	526 000		526 000	Kur duhet të arkëtohen këto vlera?		
3	467122	2 000		2 000			2 000			
4	467127	2 000		2 000			2 000			
5	467128	2 000		2 000			2 000			
6	46714003	12 000		12 000			12 000			
7	46714005	60 466		60 466			60 466			
8	46714006	122 000		122 000			122 000			
9	46714007	67 500		67 500			67 500			
10	46714008	75 000		75 000			75 000			
11	46714009			-	810 000		810 000	Kur duhet të arkëtohen këto vlera?		
12	46720001	24 000		24 000			24 000			
13	46720002	118 350		118 350			118 350			
14	46720004	232 000		232 000			232 000			
15	46720005	145 920		145 920			145 920			
16	46720006	42 000		42 000			42 000			
17	46720010	58 000		58 000			58 000			
18	46720013	143 938		143 938			143 938			
19	46720014	33 400		33 400			33 400			
20	46720017	129 000		129 000	60 000		189 000			
21	46720018	11 901		11 901	10 000		21 901			
22	46720019	55 000		55 000			55 000			
23	46720022			-	(8 000)		(8 000)			
24	46720024			-	60 000		60 000			
25	46720025	4 112		4 112			4 112			
26	46720026	197 400		197 400	60 000		257 400			
27	46720029	2 000		2 000	60 000		62 000			
28	46720030	72 740		72 740			72 740			
29	46720031	11 550		11 550			11 550			
30	46720032				60 000		60 000			
31	46720035	20 000		20 000			20 000			
32	46720036			-	17 500		17 500			
33	46720037	213 190		213 190			213 190			
34	46720038	58 300		58 300			58 300			
35	46720039	144 515		144 515			144 515			
36	46720040	4 000		4 000			4 000			
37	46720041	30 000		30 000	47 500		77 500			
38	46720042	33 600		33 600			33 600			
39	46720044	41 050		41 050	60 000		101 050			
40	46720045	27 400		27 400			27 400			
41	46720046	40 400		40 400			40 400			
42	46720047	12 000		12 000			12 000			
43	46720050	9 000	(2 400)	6 600			6 600			
44	46720051			-	60 000		60 000			
45	46720052	12 340		12 340			12 340			
46	46720053	32 000		32 000			32 000			
47	46720054	16 400		16 400			16 400			
	TOTALI	2 451 422	(2 400)	2 449 022	1 823 000	-	4 272 022			

Totale i saldoeve të mbartura e të pashpjegjuara për llogaritë 467 , për 47 AL të kontrolluara është 2,451,422 lekë			
Totale i saldoeve të papaguara të kuotos vjetore të vitit 2021 për 47 AL është 487,000 lekë. Së bashku edhe me detyrimet e stazhierëve shkon 1,823,000 lekë			
Vlera 1,823,000 lekë përfaqësojnë të ardhura të kontabilizuara por të paarkëtuara për llogari të vitit 2021.			

2. Kontrolli mbi detyrimet kreditore

- Detyrimet kreditore të të mbartura në çelje të vitit 2021 dhe që mbylleen dhe me datë 31.12.2021 që janë të pashpjegjuara në shënimet shpjeguese, janë si më poshtë:

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2021

Nr. rendor	Nr i llogarisë			Vlera e detyrimit	Vlera e detyrimit	Totali
1	401001			3 685		3 685
2	401005				231 800	231 800
3	401006			178 494		178 494
4	40123			132 000		132 000
		TOTALI I LLOG 401		314 179	231799,9	545 979
5	403			315 856		315 856
6	40311					0
7	40312			559 200		559 200
8	40316			145 000		145 000
9	40321				331 402	331 402
10	4032102				7 340	7 340
		TOTALI I LLOG 403		1 020 056	338 742	1 358 798
1	46702			1 087 745		1 087 745
2	46703			48 000		48 000
		TOTALI kreditor i llog 467		1 135 745		1 135 745
1	488			586 070		586 070
		TOTALI i llog 488		586 070		586 070
		TOTALI i saldove kreditore të pashpjeguara		3 056 050	802341,8	3 858 391

- Në kontabilizimet e regjistruara ka edhe gabime të konceptimit të drejtë të informacionit që duhet të japin llogaritë pasive: detyrimet tregtare janë të ndryshme nga detyrimet e tjera, prandaj duhet përdorur numërtim i ndryshëm midis tyre.

3. Kontrolli për AAM-të

- Aktivetafatgjata materiale nuk janë kontabilizuar. Gjendja e tyre është mbajtur në tabela exceli, gjë që ka bërë të humbë gjurma e regjistrimit të tyre sipas datave të blerjeve dhe llogaritjet e tyre të amortizimit. Ka mospërputhjet e emërtimeve të aseteve sipas tabelave të paraqitura me vlerat totale të raportuara në kontabilitet. Kjo bën që të mos kuptohen qartë politikat e amortizimit dhe vlerat neto të raportuara.

Mosrakordimet midis emërtimeve të grupeve të aseteve në tabelat e excelit me emërtimet e tyre në kontabilitet dhe mosrakordimi i rezultateve totale të gjendjes së AAM-ve me inventarin e paraqitur nga IEKA, e jep tabela e mëposhtme.

Vlera totale e mosrakordimit midis kontabilitetit dhe inventarit të paraqitur në tabelën excel nga IEKA, është në vlerën 349,550 lekë.

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2021

			215. Mjetet transporti			215		
			Kontabiliteti			Inventari fizik		Diferenca
Nr.rend	Përshkrimi	Sasia	VL. Fillestare	Amortizimi	VL.neto	Sasia		
1.	Autoveturë	1	3 273 550	3 273 550	0	1		
			218.1 Mobilje dhe paisje			218.1		
			Kontabiliteti			Inventari fizik		
Nr.rend	Përshkrimi	Sasia	VL. Fillestare	Amortizimi	VL.neto	Sasia		
2	Sipas tabelës		10 253 863	907 237	9 346 626	6 051 491		4 202 372
			218.2 Paisje informative					
			Kontabiliteti			Inventari fizik		
Nr.rend	Përshkrimi	Sasia	VL. Fillestare	Amortizimi	VL.neto	Sasia		
3	Sipas tabelës		1 020 803	9 687 563	-8 666 760	5 572 725		(4 551 922)
			14 548 216		679 866	11 624 216		(349 550)


VII. Pajtuëshmëria e llogarive me buxhetin

Nga analiza e buxhetit rezulton se burimet në total janë realizuar në nivelin 93%. Mos realizimi prej 7% vjen nga mungesa e krijimit të të ardhurave nga burime të tjera dhe specifikisht nga të ardhurat prej botimeve dhe trajnimeve për SKK-të dhe SNK-të të cilat nuk janë realizuar fare gjatë vitit 2021. Buxheti për këto dy zëra është parashikuar të jetë lekë 2'440K dhe realizimi është 0 lekë. Kjo vlerë e buxhetit përbën rreth 50% të zërit të të ardhurave të tjera, për këtë arsye, mosrealizimi i tyre e çon realizimin e buxhetit për të ardhura të tjera në masën 47%.

Nga ana tjetër, vihet re se buxheti për burimet kryesore të aktivitetit është realizuar në masën 104%. Kuotat fikse, i cili është dhe zeri më i lartë në këtë rubrikë, janë realizuar në masën 104% dhe ato variabël në masën 107%.

Ajo që vihet re në trendin e realizimit të kuotave fikse, është se ka një rritje nga viti 2019 në vitin 2020, që i atribuohet rritjes së numrit të anëtarëve aktivë dhe, më pas, vazhdon me një rënie nga viti 2020 në vitin 2021 në realizimin e këtij zëri që rezulton nga ulja e kuotës fikse nga 70'000 lekë në 60'000 lekë me vendimin 146 të datës 17 dhjetor 2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve. Të njëjtin trend ka ndjekur dhe burimi i të ardhurave të tjera: ngritje e lehtë nga viti 2019 në vitin 2020 dhe ulje nga viti 2020 në vitin 2021. Në grafikun nr. 1, më poshtë, paraqitet grafikisht ky trend, për dy kategoritë e të ardhurave të IEKA-s.

Grafiku 1



Në lidhje me përdorimet, vihet re se shpenzimet janë shumë më të ulta se buxheti. Shpenzimet në total janë realizuar në masën 62%. Kategoritë kryesore, të cilat kanë luajtur rol në mosrealizimin e buxhetit për pjesën e shpenzimeve, janë si më poshtë:

1. **Pagat e punonjësve.** Ky zë është realizuar në masën 62% të buxhetit ose 3'546K lekë më pak. Sipas strukturës së propozuar, IEKA duhet të ketë tetë (8) punonjës dhe drejtorin ekzekutiv. Gjatë vitit 2021 ka pasur lëvizje të punonjësve, me një numër mesatar gjatë vitit në pesë (5) të punësuar në krahasim me strukturën e propozuar prej 8 punonjësish.
2. **Honoraret për komitetet** janë realizuar në masën 22% të buxhetit që ekuivalenohet me 1'828K lekë më pak se vlera e buxhetuar. Gjatë vitit 2021, sikurse theksuar dhe më lart, Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës nuk ka zhvilluar asnjë mbledhje. Gjithashtu, Këshilli i Botimit të Revistës së Kontabilitetit & Auditimit nuk ka zhvilluar asnjë mbledhje. Komiteti i Kontrollit të Cilësisë ka zhvilluar vetëm një mbledhje. Dhe komitetet e tjera, të cilat janë mbledhur gjatë 2021, nuk e kanë realizuar buxhetin për shkak të mbledhjeve të kufizuara në numër.
3. **Kualifikimet e kandidatëve dhe AL si dhe trajnimet për SKK & SNK** janë realizuar në nivelin 49% të buxhetit, duke mos realizuar shpenzimet në vlerën 2'350K lekë.
4. **Botime dhe përkthime.** Ky zë është realizuar në nivelin 0% gjatë 2021, duke atribuar në shpenzime të ulura në vlerën 2'750K lekë.

Mos realizimi i buxhetit për zërat më lart, tregon se ushtrimi i funksioneve dhe organizimi i aktivitetit të Institutit në shërbim të anëtarëve nuk është në nivelin optimal. Të gjitha mosrealizimet e përmendura kanë pasojë negative në përparimin profesional të anëtarëve të IEKA-s.

VIII. Konstatime dhe Rekomandime

Zgjidhja e çështjeve gjyqësore. Aktualisht IEKA ka në proces disa çështje gjyqësore, të cilat kanë krijuar një situatë të paqartë dhe të pasigurtë për të gjithë veprimtarinë e IEKA-s. Duhet marrë masat, me ndihmën e një shërbimi juridik "Outsourced" për të zgjidhur sa më shpejt këto çështje dhe për të dalë nga situata konfuze në të cilën është aktualisht IEKA. Gjithashtu, duhet bërë një vlerësim në lidhje me humbjet e mundshme që mund të shkaktohen nga të gjitha proceset gjyqësore në proces dhe të provigjionohet përkatësisht vlera e humbjeve të pritshme.

Organizimi dhe funksionimi i komiteve. Nga analia e buxhetit rezulton se komitetet e krijuara në funksion dhe mbështetje të realizimit të objektivit të aktivitetit dhe veprimtarisë së IEKA-s dhe, si rrjedhojë të anëtarëve të saj, nuk kanë funksionuar plotësisht, madje, disa prej tyre nuk kanë funksionuar fare. Për nga rëndësia e tyre si KID ashtu dhe KKC duhet jo vetëm të jenë funksionale por dhe proaktive për të rritur besimin dhe sigurinë në

mirëfeksionimin e profesionit të audituesit ligjor. Për të realizuar këtë, IEKA duhet të jetë në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë dhe të plotë me BMP-në, duke mbrojtur të drejtat e audituesve ligjorë, por dhe duke siguruar zbatimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ky funksion publik.

Botimet dhe përkthimet. Nga sa u analizua më lart, zëri i botimeve dhe përkthimeve nuk ishte realizuar gjatë 2021. Botimet dhe përkthimet e standardeve të reja janë një nga shtyllat për ecurinë dhe përparimin e mëtejshëm të profesionit dhe të secilit anëtarë brenda këtij instituti. Staf i ekzekutiv i IEKA në bashkëpunim me KD duhet të gjejë të gjitha mundësitë për të zhvilluar këtë aspekt të institutit të lënë pas dore vitet e fundit.

Inventari fizik i aktiveve afatgjata dhe botimeve. Në vijim të çështjeve të ngritura nga auditimi i pasqyrave financiare të IEKA-s, dhe pasigurisë së ngritur nga audituesit e jashtëm lidhur me përputhjen e regjistrimit kontabël me atë fizik, rekomandojmë të kryhet inventarizimi fizik i të gjitha aktiveve afatgjata, si dhe inventarizimi i botimeve dhe materialeve didaktike, me kodifikimin përkatës. Ky inventarizim të përputhet me regjistrin kontabël, dhe të gjitha diferencat të paraqiten KKB dhe KD për të marrë vendimet e mëtejshme.

Përditësimi i faqes së internetit të IEKA sipas rubrikave. Duke marrë parasysh rëndësinë e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe atë që ai përfaqëson, është e domosdoshme që prezantimi ndaj të tretëve, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, të jetë i shkëlqyer dhe proaktiv. Vihe re se të gjitha aktivitetet dhe të rejat janë kryesisht të postuara vetëm në njërin prej rubrikave të faqes, atë të njoftimeve. Lidhur me sa më lart, ne rekomandojmë që drejtimi të përcaktojë një person përgjegjës për mirëmbajtjen dhe përditësimin e faqes zyrtare të IEKA-s sipas kategorive përkatëse.

Plani i KKB-së. Bazuar në kontrollin e kryer nga KKB-ja për aktivitetin e IEKA-s për vitin 2021, KKB ka nxjerrë disa pika për t'u shqyrtuar më në detaje gjatë vitit 2023 në lidhje me të gjithë aktivitetin e IEKA-s duke iu referuar dhe viteve të mëparshme. Më specifikisht, pikat e ngritura, të cilat do të përbëjnë shtyllat e planit të veprimit të KKB-së gjatë vitit 2023 mund të përmbledhen si më poshtë:

- a- Kontrolli i llogarive dhe regjistrimeve kontabël nga fillimi i databazës financiare të IEKA-s (viti 2012) me qëllim identifikimin e problematikave të mundshme dhe rregullimin e tyre.*
- b- Investigimi i të gjitha pagesave të kryera nga AL, identifikimi dhe rregullimi i gabimeve në regjistrime. Hartimi i një plani masash për të gjitha pagesat e pakryera dhe paraqitja e propozimeve për zgjidhjen e problematikës në KD.*
- c- Kontrolli i inventarizimit dhe përputhja me regjistrin kontabël. Bashkëpunim me KD-në për vendimarrjen në rast diferencash materiale.*
- d- Kontrolli i të gjitha procedurave në fuqi dhe identifikimi i mungesave në procedura. Dhenia e asistencës stafit ekzekutiv të IEKA-s në hartimin apo përditësimin e procedurave të nevojshme.*
- e- Të dorëzohet raporti i performancës së OJF-së bashkë me pasqyrat financiare, i detyrueshëm për t'u dorëzuar sipas KKK-së në zbatim të ligjit nr. 25/2018¹.*

¹https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/Udhezuesi%20per%20raportin%20e%20performances_publicuar.pdf

IX. Aneksi I*Vlerat në tabelë janë shprehur në 000 Lekë***Analiza Projekt Buxheti me Realizimin**

	Zërat e Buxhetit	Realizimi Buxhetit 2019	Buxheti Miratuar 2020	Realizimi Buxhetit 2020	Projekt Buxheti 2021	Realizimi 2021	Realizimi 2021 në %
1	Burimet	30,834	27,250	31,965	31,630	29,531	93%
1.1	Burime financiare nga Aktiviteti	27,914	24,200	28,339	25,750	26,765	104%
	Kuota fikse e anëtarësimit	15,011	14,700	16,063	13,800	14,365	104%
	Kuota variable e misioneve	8,331	7,000	8,286	8,200	8,763	107%
	Të ardhura nga regjistrimi kandidatëve	2,850	1,500	2,550	2,250	2,508	111%
	Të ardhura të tjera & Regj. Shoqërive)	1,722	1,000	1,440	1,500	1,130	75%
1.2	Burime të ardhurash të tjera	2,920	3,050	3,626	5,880	2,766	47%
	Burime (të ardhura) nga Botimet	20	150	3	1,500	0	0%
	Burime (të ardhura) nga kual. AL	122	200	410	200	570	285%
	Burime (të ardhura) nga kual.Kandidatë	791	1,500	2,910	2,880	2,196	76%
	Burime nga trajnimi i SKK/SNK	1,532	1,000	0	900	0	0%
	Të ardhura nga depozitat e kursimeve	446	200	295	400	-	0%
	Fitime/humbje kursi këmbimit	10	-	7	-	-	
2	Përdorime (Shpenzime)	29,935	33,022	23,530	38,110	23,478	62%
2.1	Shpenzime nga veprimtaria	21,937	27,522	20,449	30,760	21,267	69%
2.1.1	Pagat e punonjësve	6,244	9,336	7,042	9,400	5,854	62%
	Pagat e personelit me kohë të plotë	4,985	8,000	6,173	8,300	5,103	61%
	Sigurime shoqërore	683	1,336	869	1,100	751	68%
	Pagat personeli me kohë pjesëshme	576	-	-	-	-	
2.1.2	Honorare të Drejtimit	4,215	4,496	4,175	4,596	4,554	99%
	Honorare të KD & drejtimit përditshem	3,000	3,000	3,000	3,000	3,000	100%
	Pagesë për mbledhje të KD	1,035	1,296	975	1,296	1,254	97%
	Komiteti i Kontrollit të Brendshëm	180	200	200	300	300	100%

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm Viti 2021

2.1.3	Honorare për Autoritete e Komitete	964	1,550	895	2,350	522	22%
	Komiteti i Regjistrimit	381	350	215	350	268	77%
	Komiteti i Investigimit & Disiplinës	188	360	358	300	-	0%
	Komiteti i Edukimit Kualif. Vijueshem	201	300	278	300	160	53%
	Komiteti i Kontrollit të Cilësisë	-	200	-	1,000	72	7%
	Komiteti për kthim rishikim të Stand. Prof	150	240	-	300	-	0%
	Komiteti Standardeve Profesionale	44	100	44	100	22	22%
2.1.4	Shpenzime të Administrimit	8,953	10,740	7,738	12,914	10,337	80%
	Telefon, Fax, shpenzime interneti	190	250	163	250	366	146%
	Mirëmbajtja e regj. publik & faqes inter.	100	100	105	250	225	90%
	Energji, Ujë.	219	200	256	250	329	131%
	Kancelari, Shtypshkrime, riparime	200	300	159	300	86	29%
	Reklama, Publicitet , Njoftime	-	50	-	50	-	
	Abonime, Gazeta, revista	-	50	-	50	-	
	Udhëtime e Djeta	1,881	2,200	220	1,100	1,100	100%
	Karburant e rip. të zakonshme	210	300	288	300	47	16%
	Taksa, sigurime e parkim automjetesh	169	250	167	250	60	24%
	Shpenzime pritjeje	91	250	133	250	60	24%
	Shërbime në të tretë	252	250	231	270	242	90%
	Regjistrime në organet lokale	127	240	129	180	129	72%
	Shpenzime për kom. Bankare	97	100	96	120	84	70%
	Kuota anëtarësimi Org. Nd/kombëtare	1,788	2,100	1,524	1,500	1,736	116%
	Shpenzime të tjera	339	400	407	400	619	155%
	Shpenzime për Asamblenë	801	1,000	21	800	735	92%
	Auditimi i PF	210	200	210	280	280	100%
	Shpenzime amortizimi	2,040	2,200	1,954	2,100	1,292	62%
	Shpenzime të paparashikuara	-	-	-	-	370	
	Shpenzime Konsulence ligjore	240	300	1,676	2,000	327	16%
	BMP	2,158	1,309	2,238	2,214	1,705	77%

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm
Altin Sulejmani
Fatmira Kastrati
Eljona Hoxha

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2021

2.1.5	Investime, Meremetime	1,262	1,400	600	1,000	0	0%
	Investime (blerje AAM dhe meremetime)	1,262	1,400	600	1,000	-	0%
2.1.6	Rezervë e KD gjithsej	300	0	0	500	0	0%
2.2	Shpenzime për botime/perkthime	409	2,200	83	2,750	0	
	Botimi i SNA, KE etj.	331	700	83	1,900		
	Tekstet Kaplan te ACCA	-	1,500	-	500	-	
	Botimi i Revistes & Libra	77	-	-	350	-	
2.3	Shpenzime për kualifikimin	3,389	3,300	2,996	4,600	2,250	49%
	Shpenzime kualifikimi i kandidatëve	1,656	1,400	2,454	2,700	1,740	64%
	Shpenzime kualifikimi i AL	942	1,300	543	1,300	510	39%
	Shpenzime trajnimi i SKK/SNK	791	600	-	600	-	
2.4	Fitime/humbje kursi këmbimit	32	0	2		-39	
2.5	Aktiviteti sipas vendimit Asamblese	4,168	0	0			
3.1	Teprica nga veprimtaria kryesore	5,977	(3,322)	7,890	(5,010)	5,498	-110%
3.2	Teprica nga Publikimet	(389)	(2,050)	(79)	(1,250)	0	0%
3.3	Teprica nga kualifikimi AL & Kandidatë	(945)	(600)	324	(620)	516	-83%
3.4	Teprica nga depozitat e kursimeve	446	200	295	400	-	0%
3.5	Teprica nga kursi i këmbimit	(22)	-	5	-	39	
Teprica		2,161	-4,372	9,034	-5,480	6,053	-110%
Investime		167		-	1,000	-	
Teprica përfshirë Investimin AAM+ BMP		1,066	-7,081	6,197	-6,480	6,053	-93%

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)

Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm

Viti 2021

KOMITETI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Atin Sulejmani

Kryetar




Fatmira Kastrati

Anëtar



Eljona Hoxha

Anëtar



Tiranë, më 25 nëntor 2022

